



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/202
Datë: 21 / 4 / 2026

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, bazuar në dispozitat e nenit 14, paragrafi 2, të Statutit të UP-së, si dhe në dispozitat e nenit 3, nenit 19, pika 8, dhe nenit 28, të Rregullores së punës nr. 280, të datës 13.02.2025, pas shqyrtimit të kërkesës me nr. prot: 4/544 datë 11.11.2025 të prof. asst. Florim Grajçevcit, dekan në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, për themelimin e Institutit të Gjeodezisë dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore në Universitetin e Prishtinës (IGJIGJ), në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes procedurës qarkulluese, në mbledhjen e mbajtur më 08.04.2026, mori këtë:

V e n d i m

- I. APROVOHET kërkesa e prof. asst. Florim Grajçevcit, dekan në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, për themelimin e Institutit të Gjeodezisë dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore në Universitetin e Prishtinës (IGJIGJ).
- II. Detyrat dhe kompetencat e Institutit të Gjeodezisë dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore në Universitetin e Prishtinës (IGJIGJ) do të përshkruhen me Rregulloren e punës së IGJIGJ-së së me rastin e hartimit të saj dhe akteve tjera përcjellëse.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, në mbledhjen e mbajtur më 08.04.2026, pasi ka shqyrtuar kërkesën e prof. asst. Florim Grajçevcit, dekan në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, për themelimin e Institutit të Gjeodezisë dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore në Universitetin e Prishtinës (IGJIGJ), duke pasur parasysh se ky instituti ka për qëllim të rregullojë parimet e punës dhe funksionimin, organizimin e brendshëm, mënyrën e menaxhimit dhe autonominë operacionale, zhvillimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe profesionale në fushat e inovacionit teknologjik, gjeodezisë dhe infrastrukturës gjeohapësinore, përkrahjen për transferimin e dijes, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe ofrimin e shërbimeve shkencore, profesionale, konsulente brenda Institutit të Gjeodezisë dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (IGJIGJ) në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, që do të veprojë në kuadër të Universitetit të Prishtinës, e konsideron të arsyeshme iniciativën për themelimin e këtij instituti. Andaj, duke marrë parasysh atë çfarë u tha më lart dhe mbi këtë bazë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Asistentit të KD-së,
3. Dekanit të FIN-it,
4. Përfaqësuesit të IGJIGJ-së,
5. Zyrës Ligjore të UP-së.


Këshilli Drejtues i UP-së
Altin Sahiti, kryesues